



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 46
Prishtinë, më 7.6.2019, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani- Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku- Kastrati, Evgjëni Thaçi- Dragusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Elmi Reçica dhe Sergjan Mitroviç.

Pjesëmarrës të tjerë: Yllka Gashi, Klarisa Nuredini, praktikante, LDK; Elvira Ramadani, KDI; Arianit Behrami, Kuvendi i Kosovës; Vjeshtore Zeqiri, D+, praktikante; Marigona Berisha, GP-LDK dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 25 shkurt, 6 e 7 mars, 5 e 12 prill, si dhe 2 maj 2019;
3. Përgatitjet për organizimin e dëgjimit publik për Projektligjin e Diasporës;
4. Funkcionalizimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve;
5. Angazhimi i ekspertëve për Projektligjin për Diasporën, Projektligjin për shërbimin e jashtëm dhe Strategjinë për Marrëdhënie Ndërkombëtare;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 25 shkurt, 6 e 7 mars, 5 e 12 prill, si dhe 2 maj 2019.

Kryetarja konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 25 shkurt, 6 e 7 mars, 5 e 12 prill, si dhe 2 maj 2019.

3. Përgatitjet për organizimin e dëgjimit publik për Projektligjin e Diasporës

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se Projektligji për Diasporën ka kaluar, në parim, në seancën plenare të datës 30 maj 2019 dhe komisioni, në cilësi të Komisionit funksional e ka obligim që ta shqyrtojë dhe ta amendamentojë projektligjin. Kryetarja propozoi që në fillim të organizohet një dëgjim publik, pastaj komisioni, me angazhimin e ndonjë eksperti, mund të organizojë një punëtori, ku do të shqyrtohen të gjitha propozimet. Ajo, po ashtu, propozoi që dëgjimi publik të mbahet më datën 18 qershor 2019, duke filluar nga ora 11:00, në ndërtesën e Kuvendit. Kryetarja, përpos shoqërisë civile, kërkoi që të ftohet edhe deputeti Korab Sejdiu, nga Komisioni për Legjislacionin, i cili ka punuar në propozimin për ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, sa i përket votimit të diasporës. Ajo, më tej, shtoi se në dëgjimin publik do të ftohet edhe ministri i Diasporës ose ndonjë përfaqësues i ministrisë.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, meqenëse ligji lidhet edhe me kulturën dhe arsimin, propozoi që në dëgjimin publik të ftohet edhe kryetari i komisionit përkatës i Kuvendit.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se përfaqësuesve të shoqatave të ndryshme dhe rrjeteve të bizneseve të diasporës, mund t'u përcillet ftesa për pjesëmarrje në dëgjimin publik. Sa më shumë që të kemi përfaqësues të diasporës për këtë projektligj, aq më mirë është për dëgjimin publik.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Dëgjimi publik për Projektligjin nr. 06/L-148 për Diasporën, do të organizohet më datë 18 qershor 2019, duke filluar në orën 11:00, në ndërtesën e Kuvendit.

4. Funksionalizimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se grupi punues që i mbikëqyr ligjet e MPJ-së, nuk ka pasur asnjë aktivitet dhe ftoi që ky grup pune të ketë më shumë aktivitete. Ajo njoftoi se grupi punues duhet t'i analizojë dokumentet që kanë nga MPJ, siç janë lista e konsujve, lista e rotacionit me dokumentet që kanë ardhur nga sindikata e MPJ-së, lidhur me shkeljet që ata pretendojnë se i bëhen këtij legjislacioni. Grupi tjetër punues, është grupi që e mbikëqyr zbatimin e Ligjit për Diasporën dhe Ligjin për investime strategjike. Ajo njoftoi se ky grup e ka përfunduar punën në mbikëqyrjen e Ligjit për Diasporën dhe ftoi që të vazhdohet në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investime strategjike. Ajo, më tej, shtoi se sa i përket Ligjit për investime strategjike, komisioni i ka pasur disa raportime, mirëpo nuk ka marrë informata të mjaftueshme, sa i përket zbatimit të tij.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, njoftoi se nuk është filluar puna në mbikëqyrjen e Ligjit për investime strategjike, sepse është menduar se gjatë këtij viti, Kuvendit do t'i përcillet Ligji i ri për investime strategjike. Ajo bëri të ditur se ministri i MTI-së, gjatë raportimit, ka thënë se ligji është shumë i mirë dhe për arsye se disa anëtarë të grupit punues kanë qenë jashtë shtetit, nuk e ka thirrur mbledhjen e këtij grupi.

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se Ligji për investime strategjike, skadon në vitin 2020 dhe duhet të fillohet me përgatitjet për ligjin e ri. Ajo propozoi që grupi punues të takohet dhe të

ndërtojë një strategji të aktiviteteve, ku do të përfshihet edhe mbikëqyrja e punës së KIESA-s, si dhe të vizitohen disa komuna, të cilat janë model për formimin e zonave ekonomike, për të parë se si kanë arritur të atraktojnë investitorë strategjikë.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, pyeti lidhur mundësitë për angazhimin e ndonjë eksperti, i cili do të ndihmonte në fushën e investimeve strategjike.

Vjosa Osmani- Sadriu, shprehu mendimin se duhet të angazhohet një ekspert për grupin punues, i cili do të punojë edhe te çështjet e diasporës, por edhe te çështjet e investimeve strategjike. Një grup tjetër punues është propozuar nga deputeti Konjufca, si dhe është emëruar nga komisioni, që ta udhëheqë atë grup punues për ndërtimin e strategjisë për 5 vendet mos-njohëse, mirëpo nuk e dimë nëse ka pasur ndonjë aktivitet, megjithatë në emër të komisionit i bëj thirrje, që të ketë një aktivitet sa më shpejt.

Kryetarja njoftoi se vitin e kaluar, komisioni e ka kaluar Strategjinë për Marrëdhënie Ndërkombëtare, e cila duhet të përditësohet dhe të bëhet shumë më gjithëpërfshirës, sa i përket çështjeve të diplomacisë parlamentare. Lidhur me këtë, bëri të ditur se do të kontaktohet MPJ, për të parë se ku janë në procesin e hartimit të strategjisë së tyre, e cila e ka një pjesë të veçantë për njohjet, një pjesë për anëtarësim në organizata, sepse ne nuk mund të ndërtojmë strategji për njohje, që dallon komplet prej asaj që e ka Qeveria.

5. Angazhimi i ekspertëve për Projektligjin për Diasporën, Projektligjin për shërbimin e jashtëm dhe Strategjinë për Marrëdhënie Ndërkombëtare

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se në listën e ekspertëve kanë qenë rreth 10 ekspertë, që janë miratuar në komisionet paraprake, dhe nëse ka propozime që të largohet dikush nga kjo listë, duhen propozimet nga ana e komisionit. Më tej, njoftoi se në këtë mandat i kemi propozuar vetëm tre ekspertë për fusha të ndryshme që ata mbulojnë. Po ashtu, kryetarja njoftoi se për Projektligjin për shërbimin e jashtëm, KDI-ja ka sjellë një hulumtim dhe kërkoi që të kontaktohet KDI-ja, për të parë gatishmërinë e tyre nëse janë të gatshëm të ofrojnë ekspertizë shtesë, përveç hulumtimit të ofruar, për këtë projektligj. Sa i përket Strategjisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare, tha se duhet patjetër angazhimi i një eksperti.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Autorizohet kryetarja e komisionit, që të kontaktojë me 3 ekspertë nga lista e ekspertëve, lidhur me hartimin e Strategjisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

6. Të ndryshme

Vjosa Osmani- Sadriu, sipas planit të punës, njoftoi se janë paraparë të ftohen për raportim zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, lidhur me Këshillin e Evropës, znj. Dhurata Hoxha, lidhur me liberalizimin e vizave, z. Ekrem Mustafa, lidhur me Interpolin, z. Uran Ismaili, lidhur me anëtarësimin në OBSH, z. Bedri Hamza, lidhur me Organizatën e Doganave, z. Dardan Gashi dhe drejtorin e KIESA-s.

Doruntinë Maloku- Kastrati, propozoi që të ftohet ministrja e MIE-së, znj. Dhurata Hoxha, për të raportuar lidhur me liberalizimin e vizave dhe ku qëndron Kosova në raport me 5 vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Për mbledhjen e radhës së komisionit, të ftohet për raportim, lidhur me liberalizimin e vizave, znj. Dhurata Hoxha dhe të vazhdohet, varësisht prej gatishmërisë së tyre me raportimet e z. Hoxhaj, lidhur me Këshillin e Evropës dhe z. Ismaili për Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Vjosa Osmani- Sadriu, sa i përket takimi të komisionit me MPJ-në, lidhur me anëtarësimin në Interpol, tha se duhet të pritët momenti, kur të konfirmohet që Kosova do të jetë në agjendë. Njoftoi se komisioni do ta zhvillojë një vizitë në Holandë, ku fokusi do të jetë liberalizimi i vizave. Po ashtu, njoftoi se komisioni ka pranuar një ftesë nga komisioni homolog i Kuvendit të Malit të Zi, për të zhvilluar një vizitë zyrtare, në fillim të muajit korrik. Kryetarja, po ashtu, njoftoi se kemi një kërkesë nga senatori italian Licheri, kryetar i Komisionit për Çështje Evropiane, që së bashku me komisionin që e udhëheqë, ta vizitojë Kosovën, në fund të muajit qershor apo në javën e parë të muajit korrik, në mënyrë që të informohen drejtpërdrejt për zhvillimet në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.